



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.16/2024¹
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT
ADMINISTRATIV (MBPZHR) NR. 3/2015 PËR PËRCAKTIMIN E
FORMËS, PËRMBAJTJES DHE MËNYRËN E DHËNIES SË LICENCËS
PËR GRUMBULLIMIN DHE PËRPUNIMIN INDUSTRIAL TË DUHANIT
DHE PRODUKTEVE TË TIJ

¹ Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr.16/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 3/2015 për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe mënyrën e dhënies së licencës për grumbullimin dhe përpunimin industrial të duhanit dhe produkteve të tij, i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datën 09.08.2024.

Në mbështetje të nenit 4 paragrafi 3, Neni 12 paragrafi 3 të Ligjit Nr.04/L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.26/25 Nëntor 2015), duke marrë parasysh nenin 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, dt. 01 Mars 2019), në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullore (QKR) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare 21.06/2024), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.16/2024
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV
(MBPZHR) NR. 3/2015 PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS, PËRMBAJTJES DHE
MËNYRËN E DHËNIES SË LICENCËS PËR GRUMBULLIMIN DHE PËRPUNIMIN
INDUSTRIAL TË DUHANIT DHE PRODUKTEVE TË TIJ**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 3/2015 për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe mënyrën e dhënies së licencës për grumbullimin dhe përpunimin industrial të duhanit dhe produkteve të tij me qëllim të krijimit të bazës ligjore për zbatimin e akteve nënligjore nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari që i përcaktojnë dhënien e lejeve dhe licencave për grumbullimin dhe përpunimin industrial të duhanit dhe produkteve të tij.

Neni 2

Në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjalia “Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve” zëvendësohet me fjalinë “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”.

Neni 3

Neni 5 nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Udhëzimit Administrativ bazik, fshihen, dhe shtohet një paragraf i ri si në vijim:

2. Në sistemin elektronik krijohet forma e licencës elektronike e cila përmban elementet sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe ka vlerën e njëjtë si certifikata fizike e cila mund të shkarkohet nga personi në çdo kohë përmes këtij sistemi.

Neni 4

Neni 6 nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3. dhe 1.4 të Udhëzimit Administrativ bazik, fshihen, dhe shtohet një paragraf i ri si në vijim:

2. Në sistemin elektronik krijohet forma e licencës elektronike e cila përmban elementet sipas Neni 6 të Udhëzimit Administrativ bazik dhe ka vlerën e njëjtë si certifikata fizike e cila mund të shkarkohet nga personi në çdo kohë përmes këtij sistemi.

Neni 5

Neni 9 paragrafin 1 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Sekretarit të Përgjithshëm” zëvendësohet me fjalën “Drejtorit Ekzekutiv”, dhe paragrafi 2 fshihet dhe riformulohet me tekstin si vijon:

2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Neni 6

Neni 10 paragrafin 2 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjalia “Drejtorit të Departamentit për Politika Bujqësore dhe Tregjeve” zëvendësohet me fjalinë “Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Ushqim dhe Veterinari”.

Neni 7

Neni 11 paragrafin 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje” zëvendësohet me fjalën “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”, dhe në paragrafin 3 të këtij neni fjala “Sekretari i Përgjithshëm” zëvendësohet me fjalën “Drejtorit Ekzekutiv”.

Neni 8

Neni 12 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

Neni 9

Neni 13 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

Neni 10

Neni 14 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregjeve” zëvendësohet me fjalën “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Faton PEÇI

